

Në bazë të vendimit për shpalljen e konkursit për nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme me rastin e Ditës botërore të kursimeve - 31 tetor dhe Ditës botërore të sigurimit - 1 nëntor dhe miratimit të mjeteve financiare O nr. 02-29685/1 të datës 18.9.2018, Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë, Ministria e Finansave të Republikës së Maqedonisë dhe Agjencioni e mbikëqyrjes së sigurimeve publikojnë

KONKURS

Për nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme me rastin e

Ditës botërore të kursimeve - 31 Tetor

Dhe Ditës botërore të sigurimeve - 1 nëntor

1. Temat dhe kushtet e konkursit për nxënësit e shkollave fillore

Nxënësit e shkollave fillore mund të dërgojnë **vepër letrare –**

Vjershë dhe/apo veprër arti – vizatim në njërin apo në të dyja temat:

"Edhe unë mund të kursej" dhe

"Çfarë paraqet për mua sigurimi i shtëpisë dhe familjes"

Nxënësve të arsimit fillor, veprat e të cilëve do të përzgjedhen si më të mira, do t'u ndahen gjithsej 12 shpërblime edhe atë:

- nga 3 shpërblime për vepër letrare – vjershë më të mire në të dyja temat, apo gjithsej 6 shpërblime.
- nga 3 shpërblime për vepër arti – vizatim më të mire në të dyja temat, apo gjithsej 6 shpërblime;

Nxënësve, veprat e të cilëve do të shpërblehen, do t'u ndahet shpërblim në vlerë prej 3.000,00 denarë për vepër arti dhe vepër letrare më të mire, duke depozituar shpërblimin në bankë, sipas zgjedhjes së tyre.

Afati i fundit për dorëzimin e veprave është data 15 tetor 2018.

2. Temat dhe kushtet e konkursit për nxënësit e arsimit të mesëm

Nxënësit e arsimit të mesëm mund të marrin pjesë në konkurs në dy mënyra:

a) të dërgojnë një vepër letrare - **ese** me temë: **"Kursej – mendoj për të ardhmen time"**.

Esei duhet të ketë më së shumti 1,800 fjalë dhe të përmbajë pikëpamjet personale mbi kursimet, duke pas parasysh disa nga pyetjet e mëposhtme: arsyet dhe nevoja e kursimit, rëndësia e kursimit për të ardhmen, qëndrimi i të rinjve kundrejt të të moshuarve ndaj kursimit, shprehitë familjare dhe kursimet, njohuritë e të rinjve për kursimin në institucionet financiare dhe aspekte tjera.

b) të dërgojë një vepër letrare – **tregim** me temë: **"Çfarë paraqet për mua sigurimi i shtëpisë dhe familjes"**.

Nxënësve të arsimit të mesëm, veprat e të cilëve do të përzgjedhen si më të mira, do t'u ndahen gjithsej 6 shpërblime edhe atë:

- 3 shpërblime për vepër letrare – ese më të mirë;
- 3 shpërblime për vepër letrare – tregim më të mirë.

Nxënësve, veprat e të cilëve do të shpërblehen, do t'u ndahet shpërblim në vlerë prej 6.000,00 denarë, duke depozituar shpërblimin në bankë sipas përzgjedhjes së tyre.

Afati i fundit për dorëzimin e veprave është data 15 tetor 2018.

Kushtet e përbashkëta që vlejnë për nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme:

Me qëllim të mbrojtjes së veprave të nxënësve, Ju lutemi nënshkruani veprat tuaja, në mënyrë që në anën e pasme të tyre detyrimisht shënoni informatat në vijim:

- Emri dhe mbiemri i nxënësit,
- Emri i shkollës në të cilën nxënësi ndjek mësimin (klasa/viti/komuna/fshati/qyteti),
- Emri dhe mbiemri i prindit/kujdestarit me adresën e banimit, dhe
- Numri i telefonit të prindit/kujdestarit/mësuesit/profesorit.

Mënyra e dorëzimit të veprave:

Të gjitha veprat (vizatim, vjershë, tregim dhe ese) mund të dorëzohen drejtpërdrejt në Arkivin e Bankës Popullore apo nëpërmjet postës. Veprat letrare (vjershë, tregim dhe ese) mund të dorëzohen edhe në mënyrë elektronike në adresën elektronike në vijim: edukacija@nbrm.mk.

Adresa e dorëzimit nëpërmjet postës me shenjën:

**“Për konkursin me rastin e Ditës ndërkombëtare të kursimit – 31 tetor” dhe/apo
“Për konkursin me rastin e Ditës ndërkombëtare të sigurimeve – 1 nëntor”
BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË
blvd. “Kuzman Josifovski Pitu” nr. 1, 1000 Shkup.**

Veprat e arritura do të shqyrtohen dhe vlerësohen nga juria e formuar nga përfaqësues të Bankës popullore të Republikës së Maqedonisë, Ministrisë së finansave të Republikës së Maqedonisë dhe Agjencionit të mbikëqyrjes së sigurimit.

Lista e nxënësve të shpërblyer, data dhe vendi i ndarjes së shpërblimeve do të publikohen më së voni deri më date **31 tetor 2018**, në faqet e internetit të të tre institucioneve: të Bankës popullore <http://nbrm.mk/>, të Ministrisë së finansave <http://finance.gov.mk/> dhe të Agjencionit të mbikëqyrjes së sigurimeve <http://aso.mk/>.

Për informata të detajuara Ju lutemi drejtohuni në postën elektronike të Bankës popullore: edukacija@nbrm.mk, Ministrisë së finansave: finance@finance.gov.mk dhe Agjencionit të mbikëqyrjes së sigurimeve: contact@aso.mk.